



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. 18463 Prot.

Durrës, më 24 / 10 / 2017

KONTRATË PROKURIMI
SHËRBIM

Nr i Referencës BD.PH.55.17

Me objekt:

“Modernizimi i shërbimit të informimit të qytetarëve nëpërmjet dixhitalizimit dhe standartizimit dhe të dhënave gjeohapesinore te titujve te pronesisë dhe bizneseve te Bashkise Durres”

Lidhur ndërmjet palëve

BASHKIA DURRËS “Autoriteti Kontraktor”

Dhe

LORENCO & CO “Kontraktuesi”

Bashkia Durrës

1

LORENCO & CO

K O N T R A T Ë Shërbimi

“Modernizimi i shërbimit të informimit të qytetarëve nëpërmjet dixhitalizimit dhe standartizimit dhe të dhenave gjeohapësinore të titujve të pronësive dhe bizneseve të Bashkisë Durrës”

Kjo Marrëveshje (Kontratë) nënshkruhet sot më datë 24.10 2017, Durrës ndërmjet dy palëve :

“Autoriteti Kontraktor” **Bashkia Durrës**
Adresa : Sheshi “Iliria”, Qyteti Durrës
Tel /fax: 052 2223 10
NIPT : K42006501R
Përfaqësuar nga Kryetari Bashkisë z. **Vangjush Dako**

Dhe

“Kontraktuesi” (shitësi) **LORENCO & CO**
Adresa : TIRANË, rruga Dritan Hoxha, Pallati i Ri 8- katesh përballë Procredit Bank
Tel /Fax: e-mail: info@lorenco.co
NIPT : J61903071B
Përfaqësuar nga Administratori z. **Lorenc Zani**

Neni 1 Baza Ligjore

Kontrata mbështetet në ligjin nr 9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik”, KPK dhe KVK në dokumentat e tenderit, Ligji nr. 139/2015 “PER VETEQEVERISJEN VENDORE dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

1.1 Kontrata do të përbëhet nga dokumentet e mëposhtme dhe dokumentat të tjera të tenderit të datës 25.09.2017 duke përfshirë KPK dhe KVK në dokumentat e tenderit

1. Sigurimi i kontratës në shumën 10 % të vlerës së kontratës në formën e garancisë lëshuar nga shoqëri sigurimi .

2. Oferta teknike dhe ekonomike paraqitur nga kontraktuesi në tender dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktor , me specifikimet teknike, projekti, preventivin me çmimet për njësi dhe vlerën sipas Aneks-kontratës.

1.2 Fjalët dhe shprehjet në këtë kontratë do të kenë të njëjtin kuptim ashtu siç përcaktohen në Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës në dokumentat e tenderit.

Neni 2 – Objekti i kontratës

2.1 Objekt i kësaj kontrate është shërbimi nga ana e Kontraktuesit dhe blerja e shërbimit nga ana e Autoritetit Kontraktor për “Modernizimi i shërbimit të informimit të qytetareve nepermjet dixhitalizimit dhe standartizimit dhe të dhenave gjeohapësinore të titujve të pronësive dhe bizneseve të Bashkisë Durrës” specifikuar në Aneks 1 (bashkangjitur) të kontratës.

Neni 3 – Çmimi i kontratës

3.1 Çmimi që i paguhet Kontraktuesit (shitësit) për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të kontratës total është: 22’250’000 (njëzet e dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe me vleftë me tvsh: 26’700’000 (njëzet e gjashtë milion e shtatëqind mijë) lekë.

3.2 Çmimi i kontratës është fiks i pandryshueshëm dhe përfshin të gjithë ngarkesën fiskale dhe detyrimet e tjera për kryerjen e shërbimit.

Neni 4 - Afatet e Shërbimit

4.1 Afati i shërbimit do të jete 120 ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 5 – Mënyra dhe afatet e pagesës

5.1 Pagesa do të kryhet me transfertë bankare brenda 30 ditëve nga data e pranimit të shërbimit kundrejt paraqitjes zyrtare të dokumentave të mëposhtëme:

a) Fatura origjinale e shërbimit

b) Materiali i kërkuar sipas Termave të referencës në Aneksin 1 të kësaj kontrate

Monedha e pagesës do të jetë monedha Leke.

5.2 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 6 - Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet t’i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.

6.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

6.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

6.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të

marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 7 - Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 7.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 7.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 8 - Lejet dhe Liçensat

8.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 9 -Forca Madhore

- 9.1 Kontraktuesi do të çlirohet nga përgjegjësia për moszbatimin e detyrimeve kontraktuale që vijnë si rezultat i forcës madhore.
- 9.2 Nëse ndodh një situatë e tillë kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Autoritetin Kontraktor . Sipas rastit të veprimit të këtij fenomeni palët me marrëveshje e mirëkuptim përcaktojnë kushtet dhe afatet e reja praktikisht te arsyeshme per zbatimin e detyrimeve te kontrates.

Neni 10 – Ndërprerja e kontratës

- 10.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse :
- a) Kontraktuesi dështon për shërbimin brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë.
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër sipas kësaj kontrate.
- 10.2 Autoriteti Kontraktor do ti japë Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe mund ti japë kontraktuesit 5 ditë që të ndreqë mosplotësimin.

Neni 11 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 11.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura ndërmjet tyre ose në lidhje me këtë kontratë me negociata direkte.
- 11.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do ti drejtohen Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës dhe problemet do të zgjidhen sipas procedurave juridike në fuqi dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 12 –Lajmërimet

12.1 Çdo Lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

12.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 13 -Llogaritja e afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike .

Neni 14- Dispozita të fundit

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e të dy palëve në pesë kopje, 1 (një) për Kontraktuesin dhe 4 (katër) për Autoritetin Kontraktor. Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

ANEKS NR 1

“Modernizimi i shërbimit të informimit të qytetarëve nepermjet dixhitalizimit dhe standartizimit dhe të dhenave gjeohapësore të titujve të pronësive dhe bizneseve të Bashkisë Durrës”

TERMAT E REFERENCES

Termet e references janë bashkangjitur kësaj kontrate në 18 flete dhe formulari i ofertës 2 fletë.

PREVENTIV

OBJEKTI: Modernizimi i shërbimit të informimit të qytetarëve nepermjet dixhitalizimit dhe standartizimit dhe të dhenave gjeohapësore të titujve të pronësive dhe bizneseve të Bashkisë Durrës

Nr.	Emertimi	Njesi	Sasi	Cmimi	Vlera
1.1	Mbledhja dhe analizimi i të dhenave egzistuese të AMTP-ve dhe informacionit të bizneseve(set)	cope	14000	700	9,800,000
1.2	Krijimi i strukture së të dhenave dhe ngritja e sistemit (set)	cope	14000	20	280,000
1.3	Dixhitalizimi, dhe hedhja e të dhenave alfa numerike – krijimi i bazës së të dhënave në 5 njësive administrative (set)	cope	14000	80	1,120,000
1.4	Hedhja e të dhenave të përpunuara dhe integrimi i tyre në sistemin e Gjeoportalit Lokal GIS të Bashkisë (set)	cope	14000	50	700,000

1.5	Paisje NAS per backup	cope	1	200,000	200,000
1.6	Trajnime (set)	cope	1	150,000	150,000
2	Mirëmbajtja (vjet)	vit	4	2,500,000	10,000,000
				Shuma	22,250,000
				Tvsh	4,450,000
				Totali	26,700,000

AUTORITETI KONTRAKTOR

BASHKIA DURRËS

Emri dhe firma e Përfaqësuesit
Vangjush Dako
 Kryetar i Bashkisë



KONTRAKTUESI

LORENCO & CO

LORENCO ZANI

Emri dhe firma e Përfaqësuesit
Lorenc Zani
 Administrator i shoqërisë



ANEKSI 1– TERMA REFERENCEPËR PROJEKTET TIK



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
< BASHKIA DURRËS >**

**<MODERNIZIMI I SHËRBIMIT TË INFORMIMIT TË QYTETAREVE
NEPERMJET DIXHITALIZIMIT DHE STANDARTIZIMIT TE TE
DHENAVE GJEOHAPESINORE TE TITUJVE TE PRONESISË DHE
BIZNESEVE TË BASHKISË DURRËS >**

A handwritten signature in blue ink, located at the bottom left of the page.

A handwritten signature in blue ink, located at the bottom right of the page.

Lq. 1...

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

<Bashkia Durrës>

1.2. Historiku

<Nisur nga vleresimi që ka bërë sektori perkates i Bashkise Durrës për egzistencën e të dhenave gjeohapsinore për të gjithë zonën që ka në administrim, vlereson si shumë të rëndësishme realizimin e një baze të dhenash sipas standarteve të NSDI (Infrastruktura Kombëtare e të Dhenave Gjeohapsinore) për titujt e pronësive dhe bizneset e ndodhura në zonën e administruar nga Bashkia Durrës. Kjo vjen si rezultat i zgjerimit të kompetencave dhe përgjegjësi administrative të Bashkise në lidhje me titujt e pronësive si dhe rezultat i nevojës imediate për informacion gjeografik të sakte, të mirëstrukturuar dhe të perditesuar në lidhje me bizneset që operojnë në territorin e Bashkise Durrës.>

1.3. Situata Aktuale në Sektor

<Aktualisht Bashkia Durrës administron një njësi vendore e cila shtrihet në një sipërfaqe gjeografike prej rreth 340 Km².

Për përmbushjen e detyrave të saj administrative si dhe të nen-njësive administrative nën varesi të saj, dhe ofrimin e shërbimeve ndaj publikut, Bashkia bazohet ndër të tjera në të dhëna dhe informacion i cili është i natyrave të ndryshme dhe prejardhjeve të ndryshme si rrjedhojë e bashkëveprimit ndër-institucional.

Ky informacion lidhet kryesisht, por jo vetëm me vendndodhjen e titujve të pronësive dhe operatoreve ekonomike (bizneseve).

Gjithashtu në baze të VKM. Nr. 994, datë 09.12.2015 “Për Procedurën E Regjistrimit Të Akteve Të Marrjes Së Tokës Në Pronësi” dhe Ligji 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”, përgjegjësi administrative të Bashkise zgjerohen dhe si rrjedhim, Bashkia do të ketë nevojë për informacion gjeografik të sakte dhe të perditesuar në lidhje me vendndodhjen e sakte të objekteve ose parcelave si dhe individët të cilin gëzojnë ose pretendojnë të jenë pronarë të këtyre titujve pronësie.

Ky informacion i domosdoshëm për përmbushjen e detyrave të Bashkise gjenerohet kryesisht nga administrata e Bashkise dhe njësitë administrative nën varesi të saj, si dhe nga institucione të tjera Kombëtare ose lokale të specializuara në prodhimin dhe menaxhimin e këtij informacioni. Shpesh këto institucione punojnë në mënyrë manuale gjë që bën të vështirë transparencën dhe vendim-marrjen.

Ky informacion aktualisht perbehet nga te dhena alfa numerike si dhe te dhena grafike. Ne te dyja rastet informacioni eshte i lidhur ngushte me pozicionin gjeografik.

Aktualisht ky informacion disponohet ne formate te ndryshme te pa standartizuar dhe shpesh here nuk perfshin aspektin gjeografik. Nisur nga nevoja per organizimin, standartizim dhe publikimin e ketij informacioni gjeohapesinor ne perputhje me Ligjin Nr. 72/2012, VKM Nr. 669, datë 7.8.2013 dhe VKM Nr. 994, datë 9.12.2015, Ligjin Nr. 139/2015, ky projekt synon mbledhjen, pergatitjen, ruajtjen dhe perditesimin e ketij informacioni ne Gjeoportalin Lokal te Bashkise sipas standarteve teknike dhe funksionale te parashikuara ne keto legjislacione.

Jane mbi 14000 tituj pronesia qe kane problematike me regjistrimin e A.M.T.P. (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi) si rjedhoje edhe e mungeses ose pasaktetise se te dhenave ose formatit te tyre te papershtatshem.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektiv i Përgjithshëm

<Objektivi i këtij projekti është:

1. Përsosja e shërbimeve të popullates nga ana e Bashkisë nëpërmjet teknologjise dhe sistemeve te integruara te infrastruktures së portalit vendor (lokal) duke i organizuar te dhenat qe disponon bashkia në një bazë të dhënash.
2. Te dhenat (alfanumerike – gjeohapsinore) e sakta dhe te perditesuara te integruara ne portalin vendor (lokal) do te sherbejne per verifikimi i titujve te pronesia dhe bizneseve qe operojne ne territorin e administruar nga Bashkia Durrës ne nje kohe me te shpejte.

Pra objektivi kryesor i ketij projekti eshte jo vetem **krijimi i nje arkive dixhitale dhe alfa numerike por edhe krijimi i nje aplikacioni per te bere te mundur nxjerrjen, evidentimin, kontrollin dhe konfirmimin e shpejte te te gjithe titujve te pronesia.**

Mbledhja, katalogimi, dixhitalizimi, krijimi i nje baze te dhenash dhe standartizimi i te dhenave egzistuese ne Bashkine Durrës si te dhenat per bizneset vendore dhe titujt e pronesia. Keto te dhena do te merren nga Bashkia, nga njesite administrative (ish-bashkite dhe ish-komunat) dhe nga Zyrat e Tatimeve, etj.>

2.2. Qëllimi

<Qëllimi(et) i kësaj kontrate është/janë si më poshtë:

- Projekti ka si qellim rritjen e kapaciteteve teknologjike dhe cilesise se informacionit te Bashkise Durrës nepermjet mbledhjes, perpunimit dhe optimizimit te te dhenave per tu perdorur me vone ne nje sistem bashkekohor gjeo-informacioni ne perputhje me percaktimet ligjore, teknike dhe funksionale bazuar ne Ligjin Nr.72/2012, dhe VKM Nr. 669, datë 7.8.2013.

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

<Ne perfundim te ketij projekti parashikohet qe te arrihen rezultatet e meposhteme:

- Te mblidhen, katalogohen, dixhitalizohente dhenat alfa numerike dhe standartizohente dhenat egzistuese te AMTP-ve (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi)ne nje format standart qe te mund mund te perdoren me vone ne nje ambient GIS sipas percaktimeve teknike dhe funksionale te parashikuara nga Ligji 72/2012 dhe VKM. Nr. 669, datë 7.8.2013.
- Te zhvillohet dhe ndërtohet sistemi
- Te instalohet sistemi
- Te testohet sistemi
- Te mirembahet sistemi
- Te trajnohen punonjesit

Sistemi do te jete nje zgjidhje e bazuar ne procese kryesisht teknike dhe ligjore per grumbullimin, katalogimin, standartizimin dhe integrimin e te dhenave ne sistemin e portalit vendor te Bashkise.

Gjithashtu keto procese do te udhehiqen nga nevojat tekniko-funksionale te Bashkisë Durrës dhe popullates te ciles ajo i sherben.

Kjo do te lehtësoje shume punen e stafit te Bashkisë por dhe do te permiresoje shume cilesine dhe shkurtoje kohen e ofrimit te sherbimeve online ndaj popullates se Durrësit.>

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

<Ne momentin fillestar te zbatimit te projektit Bashkia duhet ti vendose ne dispozicion Kontraktorit te gjithe informacionin qe disponon ne lidhje me te dhenat egzistuese, sasine, formatet e tyre dhe vendndodhjen e tyre. Bashkia gjithashtu duhet te vendose ne dispozicion te Kontraktorit informacionin ne lidhje me infrastrukturen IT dhe GIS egzistuese.

Bashkia gjithashtu do ti garantoje Kontraktorit akses ne te dhenat dhe infrastrukturen IT egzistuese, ne sistemin e Gjeoportalit Lokal GIS.Stafi i sektorit te Kadastres, Hartografise dhe Menaxhimit te Gjeoinformacionit te Bashkisë Durrës duhet te jete ne bashkeveprim

konstant me Kontraktorin gjate zbatimit te projektit ne menyre qe te garantohet zbatimi i tij me cilesi te larte ne dhe ne afatin e percaktuar.

Ky projekt do ti mundesoje Bashkise te permiresoje nivelin e sherbimeve ndaj qytetareve dhe bizneseve, si dhe do te beje te mundur ne te ardhmen nje permiresim te ndjeshem sasior dhe cilesor ne evidentimin dhe mbledhjen e taksave dhe tatimeve vendore te bizneseve.

Me kete informacion te sakte dhe te perditesuar ne dispozicion, Bashkia do te permiresoje cilesine dhe do te shkurtoje kohën e vendimmarrjes, ndersa qytetaret dhe bizneset do te perfitojne nje sherbim me te shpejte, te sakte dhe transparent.

Ky projekt eshte i rendesishem dhe ka per qellim te shumefishte dhe lidhet shume dhe me iniciativat dhe programet kombetare te Qeverise, si Shqiperia Dixhitale dhe implementimi dhe krijimi i N.S.D.I.(Infrastruktura Kombëtare e të Dhënave Gjeohapësinore)ne nivel kombetar dhe lokal.>

3.2. Rrisqet

Më poshtë paraqiten disa faktorë të cilët mund të ndikojnë në ecurinë e projektit.

1. Mos përcaktimi i personave përgjegjës të cilët do të venë në dispozicion materialet për dixhitalizim.
2. Mos organizimi i materialeve për dixhitalizim, çka do të çonte në vonesa të projektit.
3. Moskoordinim të punës midis palëve të përcaktuar në kontratë.
4. Vonesa ne realizimin e projektit nga ana e operatorit ekonomik
5. Mos përmbushja e plotë e kerkesave funksionale dhe teknike nga operatori ekonomik.
6. Eksperienca e stafit të operatorit ekonomik në të tilla projekte.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Të Përgjithshme

<Ky projekt dhe aktivitetet e parashikuara ne te bazohen ne dispozitat ligjore dhe percaktimet tekniko-funksionale te legjislacioneve te meposhteme:

- **Ligji 72/2012 “Per Organizimin dhe Funksonimin E Infrastruktures Kombetare The Informacionit Gjeohapesinor Ne Republikën E Shqiperise”.**
- **VKM. Nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën E Regjistrimit Të Akteve Të Marrjes Së Tokës Në Pronësi”**
- **VKM Nr. 1078, datë 23.12.2015 Për Miratimin e Dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, Tema - Kufijtë E Njësi Administrative”.**

- VKM Nr. 321, datë 27.4.2016 Për Miratimin e Dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Parcelat Kadastrale”.
- VKM Nr. 359, datë 11.5.2016 Për Miratimin e Dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Ndërtesat”.
- Ligji 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”.
- VKM Nr. 710, datë 21.08.2013“Për Krijimin dhe Funkionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

Ky legjislacion qendron ne baze per nevojen e zhvillimit te ketij projekti i cili ka per qellim ngritjen, persosjen e sherbimeve online te popullates dhe nga ana e Bashkisëper permiresimin e vendimarrjes ne kohe dhe cilesi.>

4.1.1 Përshkrimi i detyrës

<Detyrat e ketij projekti do te jene:

- 1- Mbledhja, analizimi, katalogimi, dixhitalizimi dhe futja e te dhenave alfa numerike ne nje baze te dhenash dhe standartizimi i te dhenave egzistuese mbi bizneset dhe titujt e pronesise nga formate te ndryshme ne nje format standart sipas percaktimeve teknike dhe funksionale te parashikuara nga legjislacioni me siper.
- 2- Krijimi i nje aplikacioni per menaxhimin dhe analizimin e te dhenave (Shiko paragrafin 13.

Nga informacioni paraprak, Bashkia Durrës disponon ose perdor nje game te gjere te dhenash mbi bizneset dhe titujt e pronesise.

Keto te dhena me natyra dhe formate te ndryshme do t'i nenshtrohen ketij procesi ne menyre qe te behet e mundur hedhja e tyre ne sistemin e Gjeoportalit Lokak te Bashkise. Burimet e ketyre te dhenave jane, por jo vetem: Bashkia Durres por edhe institucione te tjera.>

4.1.2 Hapësira gjeografike që do të mbulohet

<Hapesira gjeografike qe do te mbulohet eshte i gjithe territori administrativ i cili eshte ligjerisht kompetence e njesise vendore Bashkia Durres.>

4.1.3 Grupet e synuara

<Grupet e synuara te ketij projekti:

- Perdoruesit e Bashkise Durres.
- Perdoruesit e institucioneve te tjera qendrore ose lokale.
- Publiku i gjere qe perfshin individe, biznese, turiste, fermere, ndertues, etj.

4.1.4 Siguria e sistemit

1. Sistemi duhet të sigurojë funksionalitet për monitorimin dhe auditimin e të gjithë veprimeve të përdoruesve
2. Sistemi duhet të sigurojë të gjitha konfigurimet e sigurisë dhe kredencialet e autentifikimit të shoqëruara me një llogari të vecantë si edhe kompleksitetin e fjalëkalimeve të përdoruesve
3. Administrimi i çdo përdoruesi do të realizohet nëpërmjet aplikimit, i cili do të jetë i pajisur me një modul të veçantë të administrimit të përdoruesve. Nëpërmjet këtij moduli do të mundësohet krijimi i përdoruesve të rinj dhe menaxhimi i atyre ekzistues.

Te dhenat e mbledhura dhe te perpunuara sipas kerkesave te ketij projekti do te ruhen ne sistemin e Gjeoportalit Lokal GIS te Bashkise Durres por edhe ne nje aplikacion te mbyllur vetem per perdorim te bashkise ne menyre qe te behen gjithe analizat e mundshme per konfirmimin e titujve te pronesise ne nje kohe sa me te shkurter.

Keto te dhena do te do te mund te aksesohen nga tre grupe kryesore perdoruesish sipas politikave te aksesit te paracaktuara nga Bashkia. Keto politika aksesit do te garantojne sigurine dhe ruajtjen e cilesise dhe pergjegjshmerise se perdorimit te te dhenave ne vazhdimesi.

Klasat e sigurise persistemin, mbeshetur ne VKM nr. 945, date 02.11.2012 do te jetë sipas formulës M-D2I2K1.

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input type="checkbox"/> D0	<input type="checkbox"/> I0	<input type="checkbox"/> K0	<input type="checkbox"/> U*
<input checked="" type="checkbox"/> D1	<input type="checkbox"/> I1	<input checked="" type="checkbox"/> K1	<input checked="" type="checkbox"/> M*
<input checked="" type="checkbox"/> D2	<input checked="" type="checkbox"/> I2	<input type="checkbox"/> K2	<input type="checkbox"/> L*
<input type="checkbox"/> D3	<input type="checkbox"/> I3		

Niveli i sigurisë është i lartë (L) nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3:

* Niveli i sigurisë është i mesëm (M) nëse disponueshmëria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm:

* Niveli i sigurisë është i ulët (U) nëse disponueshmëria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

4.2. Detyrat specifike

<Detyrat e Kontraktuesit per zbatimin e projektit:

- Mbledhja dhe analizimi i te dhenave egzistuese.
- Dixhitalizimi, standartizimi dhe futja e te dhenave alfa numerike ne nje baze te dhenash.
- Krijimi i nje aplikacioni per analizimin e te dhenave (Shiko paragrafin 13).
- Hedhja e te dhenave te perpunuara ne sistemin e Gjeoportalit Lokal GIS te Bashkise.
- Percaktimi i nevojave te infrastruktures ku do te hostohet sistemi.
- Instalimi dhe testimi i sistemit
- Trajnimiti stafit
- Mirembajtja e sistemit
- Marrja ne dorëzim e projektit nga autoriteti kontraktues
- Raportimi i cdo faze te projektit te menaxheret e projektit

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

<Zbatimi i projektit do te kryhet ne zyrat qendrore te Bashkise Durrës.>

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

<Afati zbatimit te projektit eshte 4 muaj nga data e nenshkrimitte kontrates. >

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimin

<Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip në origjinal ne dy kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 5 faqesh duhet të prodhohet pas kater javesh, nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar.
- **Drafti i raportit përfundimtar** i faqeve maksimale 20 (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njejtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit

përfundimtar është 15 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme për të mbështetur një vendim të informuar mbi perpunimin e te dhenave. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.>

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

<Ne piken 6.1 pershkruhet edhe menyra e dorezimit dhe e miratimit te raporteve. Raporti i permendur me sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.>

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

<Komunikime me sisteme të tjera nuk ka.>

Në të ardhmen, nëse do të shikohet e arsyeshme integrimi në Plaformën Qeveritare të Ndërveprimit, baza e te dhenave te krijuara dhe perpunuara nga ky projekt mund te perbejë nje baze te rendesishme edhe per institucionet e tjera qendrore te cilat kanë interesi dhe që mund ti aksesojë ato nepermjet web-serviseve.

8. GARANCIA

Garancia e sistemit do te jete minimalisht 1 vit.

9. MIRËMBAJTJA

<Kuotimi dhe parashikimi i mirëmbajtjes në përputhje me dispozitat e VKM-së nr. 710, datë 21 gusht 2013, "Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit".

Mirëmbatja do të jetë 4 vjet.

10. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5-M52
1	Mbledhja dhe analizimi i te dhenave egzistuese te AMTP-ve dhe informacionit te bizneseve					
2	Furnizimi i pajisjeve fizike					
3	Krijimi i struktures se te dhenave dhe ngritja e sistemit					
4	Dixhitalizimi, dhe hedhja e te dhenave alfa numerike – krijimi i bazes se te dhënave					
5	Hedhja e te dhenave te perpunuara dhe integrimi i tyre					

	ne sistemin e Gjeoportalit Lokal GIS te Bashkise					
6	Integrimi dhe testimi i sistemit, marrja ne dorezim					
7	Trajnime					
8	Mirëmbajtja (4 vjet)					

11. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Çdo e drejtë mbi kodin burim për përmirësimet e reja të sistemit apo çdo dokumentacion që ka të bëjë me të dhe që është realizuar nga kontraktuesi duhet t'i kalojë përfituesit në format elektronik dhe në letër. Të drejtat mbi kodin e aplikacionit në përfundim të projektit do ti kalojnë Autoritetit Kontraktor (Bashkise Durrës).

12. KËRKESAT FUNKSIONALE

<Ky seksion pershkruan standartin dhe formatin teknik te te dhenave qe do te duhet te rezultojne nga perpunimi i te dhenave bruto te disponuara ne Bashki.

- 1- Subjektet tregtare (bizneset) qe jane te rregjistruara ne territorin e Bashkisë Durrës.
- 2- Titujt e pronesise të cilat do te permbajne te dhenat mbi parcelat sipas Ligjit Nr. 7501, brenda territorit të Bashkisë Durrës.

Te dhenat duhet te organizohen në mënyrë të tillë që të jenë plotësisht të integrueshme në Gjeoportalin Lokal të Bashkisë si dhe sistemin përkatës të menaxhimit të dokumenteve. Organizimi i të dhënave duhet të jetë i tillë që të lejojë verifikimin për çdo rast të parashikuar në VKM 994, datë 09.12.2015.

Në lidhje me të dhënat gjeohapsinore ato duhet te formatoohen sipas nje modeli gjeodatabase te paracaktuar. Modeli i gjeodatabases, tabela e attributeve, metadatave dhe pershkrimeve te tyre, si dhe parametrat e tjere teknike te pergatitjes dhe perpunimit te ketyre te dhenave jane te percakatura ne kuadrin ligjor te cituar në paragrafin 4.1:

Kontraktori duhet tu permbahet me perpikmeri specifikimeve teknike dhe kerkesave funksionale te pershkuara ne kete kuader ligjor.

Bashkia do ti vere ne dispozicion Kontraktorit te gjitha te dhenat e disponuara si dhe nje ekspert pergjegjes per tu dhene pergjigje te gjitha pyetjeve me karakter teknik mbi te dhenat e disponuara qe mund te kete Kontraktori gjate procesit te perpunimit te te dhenave.


Per shkak te ngarkeses se larte te punes dhe kohes se shkurter per realizimin e ketij projekti Kontraktori duhet te perdore procese dhe mjete teknologjike te automatizuara te cilat te jene ne gjendje te kontrollojne dhe te garantojne perpunimin e te dhenave me cilesi te larte dhe ne kohe te shkurter kundrejt standarteve teknike te pershkuara me siper.

Të dhënat tipike që duhet të hidhen për çdo skanim në metadata të dokumentit AMTP janë sipas tabelës më poshtë, por jo vetëm.

Emri (përfituesi)	Text
Mbiemri (përfituesi)	Text
Emri (Kryetari Komisionit ose Kryetari i Njësisë)	Text
Mbiemri (Kryetari Komisionit ose Kryetari i Njësisë)	Text
NID (Kryetari Komisionit ose Kryetari i Njësisë)	Text
Data e lëshimit	Date
Nr. Protokolli	Text
Oragani lëshues	Text
Nr. Kadastral	Number
Toponimi ngastrës	Text
Sipërfaqja (m ²)	Number
Lloji i tokës	Lookup menu


Skema paraprake e të dhënave tipike për AMTP sipas VKM-se Nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit Të Akteve Të Marrjes Së Tokës Në Pronësi”

Gjithashtu në vijim paraqitet një bllok-skemë paraprake mbi rrjedhën e punës për dixhitalizimin e dokumenteve.



Te dhenat qe kerkohen te dixhitalizohen ndodhen ne 5 njesite administrative te Bashkise Durres. Prane cdo njesie administrative do te instalohen pajiset e dixhitalizuese (Skanera, mjete fotografike, workstacion etj). Dokumentet e dixhitalizuara dhe te indeksuara (shiko

paragrafin 14) do te integrohen ne bazen e te dhenave ne serverin e bashkise. Nepermjet serverit te aplikacionit do te behet e mundur qe informacioni i databazes te konsultohet, perditesohet dhe verifikohet ne vazhdimi.



Aplikacioni i kerkuar me ane te moduleve te konceptuara sipas bazes ligjore te percaktuar me larte duhe te mundesoje:

1. Kerkimin e te dhenave;
2. Filtrimin e te dhenave;
3. Perditesimin e te dhenave;
4. Regjistrimine te dhenave te reja;
5. Kontrollin e sigurise duke ruajtur cdo ndryshim te te dhenave si dhe historikun e ndryshimeve dhe perdoruesin qe ka kryer ndryhimin
6. Menaxhimin e perdoruesve;
7. Raporte te ndryshme sipas nevojave te bashkise

Keto mjete dhe procese teknologjike te automatizuara duhet te mundesoje:

- Kontrollin ne menyre te vazhdueshme dhe konsistente te cilesise kundrejt standarteve te paracaktura te te dhenave. Keto mjete duhet te mundesoje skedulimin automatik te kontroleve te cilesise ne nje set te dhenash ne menyre qe te mund te punohet me disa sete te dhenash paralelisht.

- Kontrollin vizual te cilesise dhe saktesis se te dhenave nepermjet evidentimit te karakteristikave qe mungojne, karakteristikave te vendosura gabim. Kontrollin statistikor te nje mostre te rekordeve ose karakteristikave ne rastin kur nuk eshte praktike kontrolli i te gjitha karakteristikave te nje data seti.

- Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të kryej kontrollin e dixhitalizimit duke përzgjedhur në mënyrë sporadike dokumente dhe duke i krahasuara ato me dokumentin analog.


- Prodhimin e raporteve automatike të cilat informojnë mbi cilësinë e të dhënave. Nepermjet monitorimit të statusit të cilësive të të dhënave, të mund të evidentohen gabime të mundshme dhe të ndërhyet menjëherë për të korrigjuar saktësinë e të dhënave.

Mbasi të jete siguruar për cilësinë dhe saktësinë e të dhënave të përpunuara, Kontraktori duhet të integrojë dhe të ruajë ato në sistemin e Gjeoportalit Lokal të Bashkisë.>

13.KËRKESAT TEKNIKE

Bashkia Durrës disponon pajisjet Hardware dhe Software të Gjeoportalit Lokal Bashkiak të cilat do të jenë në funksion të realizimit të sistemit, përfshirë 2 servera dhe pajisje rrjeti. Një server është databazë dhe një server është aplikacion. Serveri databazë do të shërbejë për ruajtjen e informacionit në një bazë të dhënash relacionare. Serveri aplikacionit do të shërbejë për gjenerimin e të dhënave për verifikim të titujve të pronësive dhe të dhënave të bizneseve.

Pajisjet Hardware dhe Software që disponohen nga Bashkia Durrës paraqiten si më poshtë:



Specifikimet e serverave jane:

RackServer	
Forma	<ul style="list-style-type: none"> I montueshem ne Rack, perfshire aksesoret e montimit ne Rack.
Procesori	<ul style="list-style-type: none"> Gjenerata e re e procesoreve, 64-bit multi-core 1 Procesor x Intel E5-2620v3 (2.4GHz/6-core/15MB) Serverisuportnderi ne 2 procesore.
Memorja	<ul style="list-style-type: none"> Serveri32GBRegisteredDDR4-2133 RAM Memorjaofron Advanced ECC, Rank Spare Mode Protection
Kontrolleri RAID	<ul style="list-style-type: none"> Kontrolleri RAID me min 2GFWC per tesuportuar RAID 0, 1, 1+0, 5, 5+0, Serverisuporton Hard Disqe SATA, SAS dhe SSD
Kapaciteti i Brendshem	<ul style="list-style-type: none"> 6 x 300GB 6G 10K rpm 2.5in hot pluggable SAS HDDs Serveri ka te pakten 8 vende per HDD dhesuportonzgjerimderi ne 24 HDDs ne te ardhmen. Perfshire SATA DVD-RW Drive
Rrjeti	<ul style="list-style-type: none"> 4 porta Gigabit Ethernet e integruar
Portat e komunikimit	<ul style="list-style-type: none"> 4 x Network; 1 x Remote Management; min 1 x Porte Video; 5 x USB (1 e brendshme);
Ushqimi	<ul style="list-style-type: none"> Burimushqimiredundand, ftohesaredundand Burimiushqimitdheftothesathot pluggable
Sistemi i Operimit dhe Virtualizimi i suportuar	<ul style="list-style-type: none"> Serveri suporton sistemet e operimit MS Windows Server, RedHATLinux, SuseLinux MS, Vmware, Citrix
Siguria	<ul style="list-style-type: none"> Trusted Platform Module (TPM)
Software i Manaxhimit	<ul style="list-style-type: none"> Manufacturer Systems Management tools Diagnostics Tools including pre-failure notification

Funksionalitetet per softwaring janë (per shkak te terminologjise shume teknike, eshte perdorur gjuha angleze):

Funksionaliteti Server Software	
1. Suporti sipas standardit te OGC	
	1. GIS software has to work with spatial data using Open GIS Consortium standards
2. Arkitektura	
	1. All GIS software server with a central database (object-oriented GIS to store spatial data in a relational database environment, Internet/Intranet GIS) has to be based on the same COM, expandable architecture, to ensure maximum interoperability and scalability of all components systems. Or ability to host
3. Funksione te pergjithshme	

	1. Server software must allow geodatabase management.
	2. Server software must allow geodatabase replication.
	3. Server software must allow work with GIS Web Services.
	4. Server software must allow work with Web Mapping Applications
	5. Server software must enable Web editing of spatial data.
	6. Server software must support performing of analytical functions.
	7. Server software e must support work from mobile GIS applications along with developments tools.
	8. Server software must support the processing and analysis of raster data
	9. Server software must support geoprocessing
4. Numri i perdoruesve	
	1. Server software must support the work with an unlimited number of users.
5. Formatet e te dhenave	
	1. Server software must support Featured Classes.
	2. Server software must support attribute tables.
	3. Server software must support rasters.
	4. Server software must support Tile Maps and Layers.
	5. Server software must support networks.
	6. Server software must support topology.
6. Editimi nga shume Perdorues (MultiuserEditing)	
	1. Server software must support multiuser editing.
	2. Multiuser editing must be in accordance with the level of authority.
7. Intranet/Internet Browsers	
	1. Intranet/Internet GIS must support Internet browser Microsoft Internet Explorer (MSIE).
	2. Intranet/Internet GIS must support Internet browser MozillaFirefox.
	3. Intranet/Internet GIS must support Internet browser GoogleChrome.
8. Krijimi dhe publikimi I GISWebApplications	
	1. Intranet/Internet GIS must have tools for automated creations and publishing of GIS web application. This functionality should be available for at least 5 named users.
9. GeodatabaseReplication	
	1. Server software must support the synchronous replications of multiple geodatabases.
	2. Server software must support the offline replications of multiple geodatabases.
	3. Server software must support the asynchronous replications of multiple geodatabases.
	4. Server software must support replications of multiple geodatabases via web service.
10. Mbeshtetja (StandardsSupport)	
	1. GIS Web Services must support REST standard.
	2. GIS Web Services must support SOAP standard.
	3. GIS Web Services must support OGC standard.
11. Sherbimet ne rrjet (WebServices)	
	1. Server software must support Feature Web Services (for web editing).
	2. Server software must support GeodataWeb Services (for geodatabase replication).

	3. Server software must support Geocode Web Services (for geocoding).
	4. Server software must support Geometry Web Services (to calculate geometry such as length and area).
	5. Server software must support Geoprocessing Web Services (for spatial data modeling and analysis).
	6. Server software must support Globe Web Services (for 3D rendering).
	7. Server software must support Image Web Services (for raster data management).
	8. Server software must support KML Web Services.
	9. Server software must support MAP Web Services (for map content management)
	10. Server software must support Mobile Web Services (for publishing GIS content to mobile devices).
	11. Server software must support Search Web Services (for advanced searching).
	12. Server software must support WCS Web Services.
	13. Server software must support WFS Web Services.
	14. Server software must support WMS Web Services.
12. Nderfaqja grafike (software interfaces)	
	1. Server software must support JavaScript API programming interface for creating web GIS applications.
	2. Server software must support Apache Flex (Adobe Flex) API programming interface for creating web GIS applications.
	3. Server software must support Microsoft Silverlight API programming interface for creating web GIS applications.
	4. Server software must support programming interface for creating web GIS applications.
13. Mjediset e Zhvillimit (Development Environments)	
	1. Server software must support the development environments and a set of development tools to create web applications for .NET
	2. Server software must support the development environments and a set of development tools to create web applications for Java.
	3. Server software must support the development environments and a set of development tools to create web applications for Silverlight.
	4. Server software must support the development environments and a set of development tools to create web applications for Flex.
	5. Server software must support the development environments and a set of development tools to create web applications for OS X.
	6. Server software must support the development environments and a set of development tools to create web applications for WPF.
14. Arkivimi i geodatabazes (Geodatabase archiving)	
	1. Object based GIS software package for storing spatial data in a relational database environment must enable the storage, display and analysis of historical changes in spatial database.
15. Mjediset e Integruara të Zhvillimit (Integrated Development Environments)	
	1. Server software must support an integrated development environment Microsoft Visual Studio.
	2. Server software must support an integrated development environment Eclipse.

	3. Server software must support an integrated development environment NetBeans.
16. Metadata	
	1. Server software must allow input, processing and search of metadata.
17. Sistemi Koordinativ (Coordinate System)	
	1. Server software must support projections and coordinate system (local coordinate systems, LONG/ LATWGS 84 UTM).
18. Multiple databases	
	1. Server software must support MS SQL Express multiple databases.
	2. Server software must support MS SQL Server multiple databases.
	3. Server software must support ORACLE multiple databases.
	4. Server software must support DB2 multiple databases.
	5. Server software must support InformixDynamic Server multiple databases.
	6. Server software must support PostgreSQL multiple databases.

Pajisja e nevojshme per backup, e cila do te ofrohet nga Operatori Ekonomik:

Karakteristika Minimale Teknike	
Brand	Po
CPU	Min. 2 GHz
RAM	Min. 1 GB
HDD të Përfshirë	4x min. 1 TB
RAID i Konfiguruar	RAID 5
Nr. of bays	Min. 4
RAID Support	0, 1, 5, 10
Network Port	Min. 1 Gb Ethernet
USB Port	Min. 2 USB 3.0
OS Support	Po
FTP Server	Po
Sinjalizues mbi Gjëndjen	Po
Ushqyesi	AC 220 V / 50 Hz, European
Garancia	1 Vit

Dixhitalizimi i AMTP-ve

AMTP – Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi

Dixhitalizim kuptohet përfimi nga materiali në letër me anë të skanimit ose fotografimit të një imazhi dixhital i cili mund të ruhet në mjete elektronike.

Të dhënat teknike për dixhitalizimin janë:

Color, 300dpi minimum,A4,

Sasia: Afersisht 14000, (dy faqe, në rastin e AMTP-ve të njësuara me origjinalin)

Formati . PDF

Indeksi i AMTP-ve të skanuar duhet të bëhet në bazë të organit që e ka lëshuar dhe Emri, Mbiemri, NID e përfituesit.

Metadatat e përfshira në dokument duhet te përfshijne gjithë informacionin e mundshem.

Dixhitalizimi i informacionit per biznese-t

Informacioni do te merret nga Zyra e Taksave ne Bashkinë Durrës.

Dixhitalizimi i materialeve të përcaktuara më sipër do të kryhet me mjetet dhe pajisjet e Operatorit Ekonomik fitues referuar: skaner, mjete fotografimi, kompjuter, etj për secilën pikë, sipas bllok-skemës së paraqitur më sipër. Operatorit Ekonomik fitues do ti jepet akses në infrastrukturën ekzistuese për integrimin e këtyre të dhënave në Gjeoportalin Lokal të Bashkisë. Pas përfundimit të implementimit të sistemit mjetet dhe pajisjet e ofruara nga Operatori Ekonomik do të tërhiqen nga vetë ai.

Ambientet e nevojshme do të vihen në dispozicion nga Autoritetit Kontraktor dhe/ose grupet e interesuara.

-Fund-

Shtojca 1

Tiranë, më 25.09.2017

FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit Lorenzo & Co Sh.p.k

Për: Bashkinë Durrës

Adresat: Sheshi "LIRIA" Durrës.

Procedura e prokurimit: E hapur.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Modernizimi i Shërbimit të Informimit të Qytetareve Nepermjet Dixhitalizimit dhe Standardizimit të të Dhenave Gjeohapsinore të Titujve të Pronesisë dhe Bizneseve të Bashkisë Durrës.

Publikimi: Buletini i Njoftimeve Publike Data 04.09.2017, Nr. 35.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:


1. Çmimi total i ofertës sonë është është 22.250.000 (njetete e dy milion e dyqind e pesedhjetë mijë) Leke pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është 26.700.000 (njetete e gjashte milion e shtatëqind mijë) Leke me TVSH.



1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
1.1	Mbledhja dhe analizimi i te dhënave egzistuese të AMTP-ve dhe informacionit të bizneseve (set)	cope	14000	700	9,800,000	120 Ditë
1.2	Krijimi i struktureve të te dhënave dhe ngritja e sistemit (set)	cope	14000	20	280,000	
1.3	Digitalizimi dhe hedhja e te dhënave alfabetike - krijimi i bazës së te dhënave në 5 njesite administrative (set)	cope	14000	80	1,120,000	
1.4	Hedhja e te dhënave të përpunuara dhe integrimi i tyre në sistemin e Gjeoportalit Lokal GIS të Bashkisë (set)	cope	14000	50	700,000	
1.5	Pajisje NAS për backup	cope	1	200,000	200,000	
1.6	Trajnime (set)	cope	1	150,000	150,000	
2	Mirëmbajtja (vjet)	vjet	4	2,500,000	10,000,000	4 Vjet
Çmimi Neto)					27,250,000	
TVSH (%)					4,450,000	
Çmimi Total					26,700,000	

Nënshkrimi i ofertuesit LORENCO ZANI

Vula



LORENCO ZANI

